

Qëllimi i Shpalljes

Të besohet në një Zot të vetëm

“Zoti juaj (që meriton adhurim) është Një, All-llahu, nuk ka Zot pos Atij që është Mëshirëplotë, gjithnjë mëshiron.” Kur’an 2:163

Qëllimi kryesor i gjithë asaj çfarë përmendet në Kur’an është besimi në një Zot të vetëm dhe të vërtetë. Zoti na informon se Ai nuk ka partner, apo djalë, apo dikë të barabartë në sundim, dhe askush nuk ka të drejtë të adhurohet përveç Tij. Askush nuk është i ngjashëm me Të dhe asnjë krijesë e Tij nuk i përngjanë Atij. Kur’ani po ashtu e refuzon nocionin e përngjasimit të cilësive të njerëzve me Ato të Zotit.

Për ti refuzuar zotat e pavërtetë

“Dhe adhuroni vetëm Allahun dhe mos i shoqëroni Atij askënd (në adhurim).” Kur’an 4:36

Pasi që vetëm Allahu është ai i cili meriton adhurimin, zotrat e trilluar duhet të refuzohen. Kur’ani poashtu refuzon që t’i përkshruhen cilësitë e Zotit dikujt tjetër apo diçkaje tjetër përpos Tij.

Për t’i treguar ngjarjet e mëparshme

Kur’ani përmban shumë tregime me mësim përfutuese, përfshirë tregimet e vërteta të profetëve të kaluar si: Adem, Nuh, Ibrahim, Isai dhe Musai. Për këto tregime, Allahu thotë, *“Me të vërtetë në tregimet e tyre ka mësim për njerëzit që kuptojnë.” Kur’an 12:111*

Për të na e kujtuar Ditën e Gjykimit

Libri Fisnik neve na kujton se të gjithë do ta shijojnë vdekjen dhe do të llogariten për veprat e tyre dhe për thëniet e tyre: *“Në ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshoja të drejta, e askujt nuk i bëhet e padrejtë asgjë, edhe nëse është (vepra) sa peshja e një kokrre të melit Ne do ta sjellim atë. E mjafton që Ne jemi llogaritës...” Kur’an 21:47*

Për të pëmbushur qëllimin e vërtet të jetës

Po ashtu është me rëndësi të madhe se Kur’ani na tregon se qëllimi i jetës është adhurimi i Zotit të vetëm si dhe për ta jetuar jetën sipas rrugës që Ai ka zgjedhur për ne. Në Islam, adhurimi është një shprehje gjithëpërfshirëse që përfshin të gjitha veprat dhe thëniet (në privatësi apo para të tjerëve) që Allahu i do dhe është i kënaqur me to. Prandaj, duke e bërë atë që Allahu na urdhëron, Muslimani është duke e adhuruar Zotin dhe duke e pëmbushur qëllimin e tij për çfarë është krijuar. Këto janë shembujt e adhurimit nga Kur’ani:

Për tu falur: *“O ju që besuat, falni namazin me ruku e sexhde dhe vetëm Zotin tuaj adhurojeni. Bëni punë të mira (të dobishme), pasi do të gjeni shpëtim.” Kur’an 22:77*

Për bamirësi: *“...dhe jepni për të mirën tuaj, e kush i ruhet lakmisë së vetvetes, të tillët janë të shpëtuarit.” Kur’an 64:16*

Për të qenë i sinqertë: *“E mos e ngatërroni të vërtetën me të pavërtetën dhe me vetëdije të fshehni realitetin.” Kur’an 2:42*

Për të qenë modest: *“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata. Thuaju edhe besimtarëve të ndalin shikimet e tyre, t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre.” Kur’an 24:30-31*

Të jesh falënderues: *“All-llahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja (si foshnje) që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, ashtu që të jeni falënderues.” Kur’an 16:78*

Të jesh i drejtë: *“O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hir të All-llahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) i pasur ose i varfër...” Kur’an 4:135*

Të jesh i durueshëm: *“Dhe ti, bëhu i durueshëm, se All-llahu nuk ua humb shpërblimin bëmirsve.” Kur’an 11:115*

Të jesh i mirë: *“Atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, All-llahu u premtoi falje për mëkate dhe shpërblim të madh.” Kur’an 5:9*

Përfundim

Në një përmbledhje, Kur’ani i tregon njerëzimit se si duhet adhuruar Zotin Një të vetëm, kështu që e pëmbushin qëllimin e tyre të vërtetë dhe arrijnë sukses në këtë botë dhe në botën tjetër.

“Ne ta shpallëm ty librin me argumente për njerëz, e kush orientohet në rrugën e vërtetë, ai e ka për vete, e kush e humbë, ai i bën dëm vetëm vetes, e ti nuk je garantues i tyre.” Kur’an 39:41

A nuk mendoni sa i keni borxh vetvetes suaj që ta lexoni një herë këtë Libër Fisnik?

Informacion

tel 045 633 370 web islamifejaevartetete.com @ broshurat@gmail.com

Emri i bankës Pro Credit Bank

Kontoja 1184001037000102 Swift MBKORS22

gjërat
themelore

islamifejaevartetete.com

Kur’ani

Shpallja e Fundit tek Njerëzimi



Ç 'është Kur'ani?

Fjala e Zotit

Kur'ani është fjala e Zotit, të Gjithfuqishmit (Allah në gjuhën arabe) që i është shpallur Profetit Muhammed (paqja qoftë mbi të) përmes Engjëllit Xhibril.

“Shpallja e Librit është prej All-llahut, të Gjithfuqishmit, të Urtit.” Kur'an 39:1

Udhëzim për njerëzimin

Kur'ani është **“udhëzim për njerëzimin... dhe sqarues (mes të drejtës dhe të gabuarës).” Kur'an 2:185**

Ofron mundësi ta ndihmojë njerëzimin në gjykimin e tij mes të drejtës dhe të gabuarës, pa të cilin, njeriu natyrisht se do të ishte në humbje.

Shpallja e fundit

Kur'ani është shpallja e fundit e shpallur nga All-llahu i Gjithfuqishëm (Zoti), dhe konfirmues i disa pjesëve të pakta të mbetura nga shpalljet e mëparshme. Poashtu Kur'ani i refuzon dhe korrekton fabrikimet dhe shtimet në versionet e ditëve të sotme të këtyre shpalljeve.

“O ju që u është dhënë libri, besojeni atë që e zbritëm (Kur'anin) e që është vërtetues i atij që e keni...” Kur'an 4:47

Si ishte shpallur Kur'ani?

Kur'ani i ishte shpallur Muhammedit (paqja qoftë mbi të) dhe ekziston vetëm në gjuhën në të cilën ishte shpallur - në arabe. Sidoqoftë, përkthimi i kuptimeve të Kur'anit gjendet në shumë gjuhë.

Kur'ani nuk ishte zbritur si libër i plotë përnjëherë, por shpallja zgjati në një periudhë 23 vjeçare.

Për këtë arsye, është esenciale të dihet se në çfarë rrethanash janë shpallur versetet në mënyrë që ta kuptojmë më mirë Kur'anin, përndryshe, mësimet e tij mund të keqkuptohen.

Ruajtja

Kur'ani është i vetmi libër i shenjtë që ka qenë në qarkullim për një kohë të gjatë dhe përsëri mbetet i pastërt dhe pa ndryshime sikurse ishte zbritur. Asgjë nuk është shtuar, larguar apo përmirësuar në të, që nga koha e shpalljes së tij, prej më tepër se 1400 vite më parë.

Jo vetëm që Kur'ani është ruajtur në formën e shkruar, por gjithashtu edhe në zemrat e burrave, fëmijëve dhe grave. Sot, miliona njerëz kanë memorizuar Kur'anin që nga fillimi deri në fund.

Mrekullitë shkencore

Kur'ani nuk e kundërshton shkencën moderne por përkundrazi, e përkrah atë. Një nga aspektet më madhështore të Kur'anit është se përmban versete të cilat saktësisht përshkruajnë fenomene natyrale të shumë fushave si në: embriologji, meteorologji, astronomi, gjeologji, oqeanografi etj. Shkencëtarët i kanë gjetur këto përshkrime shumë të sakta nga ky Libër që daton nga shekulli i 7-të.

Në fakt, shumë nga mrekullitë shkencore të përmendura në Kur'an janë zbuluar në kohët e fundit përmes përparimit të mjeteve teknologjike. Shiko pikat në vazhdim:

“Ne do t'ua bëjmë të mundshme atyre t'i shohin argumentet tona në horizont dhe në vetveten e tyre deri sa t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë.”
Kur'an 41:53

- Kur'ani cek se objektet astronomike (yjet, planetet, hënat etj. ...) të gjitha ishin të formuara nga retë e pluhurit, më herët i panjohur. Ky fakt tashmë është bërë një gjë e padyshueshme në të nga kosmologjia moderne.
- Shkenca moderne ka zbuluar se ndarjet që lejojnë 2 detrat të takohen, prapsepapë ato vazhdojnë të kenë temperaturën, dendësinë dhe shijen e pandryshuar.

Këto shenja të Zotit ishin cekur qartë në Kur'an prej më shumë se 1400 vjet më parë.

Si e di unë që ky Libër është nga Zoti?

E veçanta

Që kur është shpallur, asnjë person nuk ka qenë në gjendje të shpikë një kaptinë sikur ato që gjinden në Kur'an, me bukurinë, elokuencën, shkëlqimin, profecitë dhe atributet tjera perfekte.

Njerëzit që e refuzuan Profetin Muhammed (paqja qoftë mbi të) dështuan në këtë sfidim, edhe ata ishin jashtëzakonisht elokuentë në gjuhën e Kur'anit. Ky sfidim mbetet pa përgjigje edhe sot.

Nuk ka kontradikta

Kur njerëzit shkruajnë, ata janë të prirur për të bërë gabime si në shqiptim poashtu edhe në gramatikë, thënie kontradiktore, fakte jo korrekte, përzjerje të informacioneve dhe shumë gabime të ndryshme.

“A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej All-llahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.”
Kur'an 4:82

Në Kur'an nuk ka aspak kontradikta, çfarëdo qofshin ato në spjegime shkencore te ciklit të ujit, embriologji, gjeologji, kosmologji, fakte historike, ngjarje të ndryshme apo parashikime.

A nuk ka mundur që vetë Muhammedi të jetë autori i Tij?

Profeti Muhammed (paqja qoftë mbi të), është e njohur në histori të ketë qenë i paarsimuar; nuk ka ditur të lexojë dhe të shkruajë. Nuk ka qenë i edukuar në asnjë fushë e cila do t'i ndihmonte për ndonjë të dhënë shkencore, apo bukurinë madhështore të shprehjeve në këtë Libër. Preciziteti i ngjarjeve historike të njerëzve dhe civilizimeve të ndryshme të përmendura në Kur'an është po ashtu e pamundur të jenë shkruar nga ndonjë njeri.

“Nuk është e logjikshme të mendohet se ky Kur'an është i trilluar prej dikujt pos All-llahut, por është vërtetues i asaj (shpalljes) që ishte më parë dhe sqarues e komentues i librit. Nuk ka farë dyshimi se është (i zbritur) nga Zoti i botëve.”
Kur'an 10: 37

“Ne me Madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.”
Kur'an 15:09

“E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë sillni ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kur'ani) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotërat) pos All-llahut, nëse jeni të sigurtë (në thëniet tuaja se Kur'ani nuk është prej Zotit).”
Kur'an 2:23